

1. Titulli i projektit: FMN - Reformat Fiskale në Evropën Juglindore - Faza III (nën-Kapitulli Administrimi i të Ardhurave)

Afati kohor i projektit: 2023-2026

Ky projekt synon të ndërtojë më tej kapacitetet njerëzore dhe institucionale të nevojshme për:

- Adresimin e angazhimeve për konsolidimin fiskal.
- Menaxhimin e pasigurive dhe përgjigjet e politikave.
- Mbështet rimëkëmbjen pas pandemisë dhe rritjen e qendrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Rezultatet e pritura:

- Forcimi i menaxhimit dhe qeverisjes së Administratës së të Ardhurave.
- Fuqizimi i funksioneve bazë të administratës tatimore.

Komponentët dhe objektivat përkatës:

- Menaxhimi i riskut - Identifikimi, vlerësimi, renditja dhe sasia e risqeve të përputhshmërisë dhe zbutja e tyre gradualisht u përmirësua përmes zbatimit të një CIP që plotëson praktikatat e mira ndërkombëtare bazuar në pikët e TADAT POA.
- Rregullimi organizativ - Ndarja e qartë e roleve dhe përgjegjësiive zbatohet në të gjithë organizatën. Përmirësimet e pajtueshmërisë arrihen përmes modernizimit të kornizës operacionale.
- Pagesa e taksave - Pagesat në kohë të taksave janë përmirësuar gradualisht për të përmbushur praktikatat e mira ndërkombëtare bazuar në pikët e TADAT POA. Niveli i borxhit të arkëtueshëm reduktohet në maksimum dhjetë për qind të të ardhurave totale.
- Auditimi - Zbatohet verifikimi i automatizuar i të gjitha deklaratave tatimore përmes kryqëzimit me të dhënat përkatëse të brendshme dhe të palëve të treta. Monitorimi i zbatuar i boshllëqeve tatimore në të paktën një nivel të shëndetshëm të performancës, në përputhje me standardet TADAT.

Rezultatet e arritura dhe ndikimi:

- Pajtueshmëria me propozimet e projektimit iu dorëzuan MFE- së;
- Është përgatitur dhe miratuar plani vjetor i përmirësimit të pajtueshmërisë për vitin 2024; Është krijuar dhe funksionon struktura e qartë organizative përgjatë linjave funksionale dhe/ose segmenteve të tatimpaguesve;
- Është miratuar një ndarje e qartë e roleve dhe përgjegjësiive ndërmjet SHQ (përkufizimi i procedurave standarde të funksionimit, planifikimi dhe monitorimi) dhe degëve lokale (ekzekutimi).